

VENDIM
Nr. 19, datë 6.2.2023

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “RENRGY TRADING GROUP”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË
ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 163, DATË 19.7.2018**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, si dhe neneve 13 dhe 16, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1/7 prot., datë 3.2.2023 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës nr. 417, seria T18, të shoqërisë ‘ReNRGY Trading Group’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 6, datë 16.1.2023 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 17.1.2022 dhe 18.01.2022), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.1.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Në nenin 16, pika 1, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 417, seria T18, është 19.7.2023).

Sikurse konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 4.1.2023, pra, brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar; aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

- Neni 16, germa “a”. Formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1.

- Neni 9, pika 1, germat “a”, **plotësuar.**

- Neni 16, germa “b”, **plotësuar.**

- Neni 16, germa “c”, **plotësuar.**

- Neni 16, pika 7, **plotësuar.**

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aeksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa u përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 417, seria T18, të shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 163, datë 19.7.2018, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 20.7.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti